



D

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nr. 9528 prot.

Tiranë, më 28.5.2021

URDHËR

Nr. 50, datë 28.5.2021

**“PËR
NGRITJEN E KOMITETEVE TË MENAXHIMIT TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË TATIMEVE SI DHE PËRCAKTIMI I RREGULLAVE TË
FUNKSIONIMIT PËR GRUPET E PËRHERSHME TË PUNËS“**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe në zbatim të planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna sipas Raportit të FMN, “Albania Maintaining the Pace of Tax Administration Modernization” Dhjetor 2017, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komiteteve të menaxhimit të punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si vijon; Komiteti i Reformave, Komiteti i Operacional dhe Komiteti i Përmbushjes. Përbërja dhe detyrat e këtyre Komiteteve janë si më poshtë:
 - 1.1 Komiteti i Reformave përbëhet nga:

- Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve	Kryetar
- Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve	Anëtar
- Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve	Anëtar
- Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Funksioneve Operacionale	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë Teknike dhe Ligjore	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore	Anëtar

- | | |
|---|--------|
| - Drejtori i Drejtorisë së Proceseve të Biznesit | Anëtar |
| - Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor | Anëtar |
| - Drejtori i Drejtorisë së Marrëdhënieve më Jashtë dhe Menaxhimit të Projekteve | Anëtar |
| - Drejtorja e Financës dhe Buxhetit | Anëtar |
| - Drejtorja e Menaxhimit të Riskut | Anëtar |
| - Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve | Anëtar |
| - Drejtorja Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara | Anëtar |

Në varësi të temës së diskutuar, në Komitet thirren të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Grupit të Menaxhimit Startegjik (GMS) sipas fushës së përgjegjësisë dhe objektivit të prezantimit.

1.1.1 Detyra e Komitetit të Reformave është drejtimi strategjik i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe mbikqyrja e zbatimit të planit të reformave. Komiteti mbidhet minimalisht një herë në muaj, por si rregull sipas një grafiku të përcaktuar nga sekretariati në fillim të çdo viti kalendarik. Komiteti mund të mbledhet dhe herë të tjera jashtë grafikut nëse çmohet e nevojshme. Në mënyrë të veçantë, Komiteti do të:

- ✓ Miratojë dhe zhvillojë planin strategjik të DPT-së;
- ✓ Konceptojë dhe mbikqyrë zbatimin e nismës për modernizimin e funksionimit të Administratës Tatimore, duke siguruar që kjo nismë dhe nisma të tjera të reformës të kuptohen dhe gjejnë mbështetje brenda dhe jashtë Administratës Tatimore;
- ✓ Sigurojë drejtimin strategjik dhe mbështetje të projekteve në funksion të progresit të Administratës Tatimore;
- ✓ Rishikojë dhe rifreskojë rregullisht planin strategjik, për të siguruar se ai mbetet i përshtatshëm në një mjedis ekonomik dinamik;
- ✓ Miratojë rregullore me aplikim të përgjithshëm në Administratën Tatimore.
- ✓ Të ndjekë e të monitorojë çuarjen përpara të nismave reformuese duke siguruar mobilizimin në mënyrën e duhur të burimeve njerëzore dhe financiare e logjistike;
- ✓ Të zgjidhë problematikat/pengesat e dala gjatë zbatimit të detyrave të rëndësishme projekteve të ndryshme, etj., në funksion të progresit të Administratës Tatimore (psh.: burimet njerëzore dhe financiare, ndryshimet ligjore, bashkëpunimin me institucionet e tjera).

1.2 Komiteti i Operacional përbëhet nga:

- | | |
|--|---------|
| - Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve | Kryetar |
| - Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve | Anëtar |
| - Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve | Anëtar |
| - Zv/Drejtori i Përgjithshëm Funksioneve Operacionale | Anëtar |
| - Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj | Anëtar |

- Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	Anëtar
- Drejtori i Shërbimit të Tatimpaguesve	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë Teknike dhe Ligjore	Anëtar
- Drejtori i Analizës dhe Kontabilitetit	Anëtar
- Drejtor i Drejtorisë së Hetimit Tatimor	Anëtar
- Drejtor i Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren	Anëtar
- Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Specializuar	Anëtar

Në varësi të temës së diskutuar, në Komitet marrin pjesë Drejtues të tjerë sipas fushës së përgjegjësisë dhe objektit të prezantimit.

1.2.1 Detyra e Komitetit Operacional është administrimi i procesit të planifikimit vjetor dhe monitorimit të performancës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Komitetet mbidhen minimalisht një herë në muaj, por edhe herë të tjera jashtë grafikut nëse çmohet e nevojshme. Në mënyrë të vecantë, Komiteti do të:

- ✓ Miratojë manualët operacionale të punës së çdo strukture dhe çdo ndryshim të tyre në rast rishikimi, në përputhje me Rregulloren e Brendshme të DPT dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
- ✓ Të miratojë planet operacionale të punës në zbatim të planit strategjik të Administratës Tatimore dhe miratimin e përmbushjes së tyre, minimalisht mbi baza 6 mujore dhe vjetore;
- ✓ Miratimi i planit vjetor të të ardhurave;
- ✓ Miratimi i planeve operacionale sektoriale;
- ✓ Sigurojë që planet vjetore të punës të përmbushin objektivat e të ardhurave të buxhetit;
- ✓ Sigurohet që plani i punës mbështet në burime të përshtatshme;
- ✓ Monitorojë mbarëvajtjen e zbatimit të planit të punës dhe ndërmarr veprime korrigjuese;
- ✓ Rishikojë dhe përditësojë në mënyrë të rregullt planin e punës, duke marrë në konsideratë rreziqet që shfaqen;
- ✓ Vlerësojë dhe analizojë performancën e Drejtorive Rajonale.
- ✓ Të miratojë rregulloren të posacme të funksionimit për struktura ose procese të caktuara teknike, pas diskutimit të tyre në Komitetin e Përmbushjes nëse kanë të bëjnë me rritjen e përmbushjes vullnetare dhe pajtueshmërisë së tatimpaguesve.

1.3 Komiteti i Përmbushjes, përbëhet nga:

- Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve	Kryetar
- Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve	Anëtar
- Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve	Anëtar
- Zv/Drejtori i Përgjithshëm Funksioneve Operacionale	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj	Anëtar

- Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë Teknike dhe Ligjore	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	Anëtar
- Drejtor i Drejtorisë së Hetimit Tatimor	Anëtar
- Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Specializuar	Anëtar

1.3.1 Komiteti i Përbushjes ka për detyrë zbatimin e një sistemi modern të menaxhimit të rrezikut të pajtueshmërisë dhe promovimin e zhvillimit të strategjive të integruara të përmirësimit të pajtueshmërisë. Komiteti mbidhet minimalisht një herë në muaj, por edhe herë të tjera jashtë grafikut nëse çmohet e nevojshme. Në veçanti, Komiteti do të:

- ✓ Identifikojë dhe do t'ju japë prioritet rreziqeve të mëdha të pajtueshmërisë sipas një procesi të strukturuar të vlerësimit të rreziqeve;
- ✓ Identifikojë ato rreziqe të pajtueshmërisë, që përfaqësojnë një nivel të mjaftueshëm kërcënimi për të tërhequr vëmendjen e vazhdueshme të ekzekutivit të lartë;
- ✓ Sigurojë që një strategji reaguese e integruar në mënyrë të përshtatshme, të veprojë për secilin prej këtyre rreziqeve të rrepta të pajtueshmërisë;
- ✓ Sigurojë që strategjitë reaguese të kenë burimet e përshtatshme (njerëz, financa, aftësitë, mjetet mbështetëse të biznesit, etj.) dhe të mbështeten nga departamentet funksionale;
- ✓ Monitorojë zbatimin dhe efektivitetin e strategjive.
- ✓ Diskutojë dhe miratojë paraprakisht çdo ndryhim të nevojshëm në rregulloret e kriteret e riskut;
- ✓ Miratojë listën e ndarjes në sektorë ekonomikë në Modulin e Riskut;
- ✓ Propozojë, diskutojë e miratojë në parim rregullore të posacme të funksionimit ose për procese të caktuara teknike që kanë për qëllim përmirësimin e pajtueshmërisë dhe përbushjes vullnetare.
- ✓ Hartimi i strategjive afatshkurta/planeve të veprimit në kuadër të një Administrate Tatimore Inteligjente.

1.4 Komitetet do të mbështeten nga Sekretariati Teknik, i cili do të përbehet nga jo më pak se tre anëtarë të caktuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

1.4.1 Sekretariati Teknik do të përgatitë dhe do t'i propozoj komiteteve planin e punës dhe afatet për zbatimin e detyrave për secilin anëtar, si dhe do të raportojë periodikisht për ecurinë e procesit, por jo më pak se një herë në muaj.

1.5 Komitetet raportojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë periodikisht për takimet e kryera dhe rezultatet e arritura.

2. Grupet e përhershme të punës, të ngritura me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, krahas detyrave të përcaktuara specifikisht në Urdhrat respektivë, do të mbidhen dhe koordinojnë lidhur me zbatimin e detyrave të lëna dhe periodikisht do të përgatisin informacion me shkrim për Drejtorin e Përgjithshëm.

2.1 Grupi i menaxhimit strategjik (GMS) i ngritur me Urdhër nr. 6, datë 31.01.2018, "Për krijimin e Grupit për Menaxhimin strategjik (GMS)", përbëhet nga:

- Titullari i njësisë Publike,
- Nënpunësi zbatues,
- Të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë.
- Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm merr pjesë në mbledhjen e GMS-së, pa të drejtë vendimmarrje.

Veprimtaria dhe përgjegjësitë e GMS-së janë:

- Sigurimi i një kontrolli të brendshëm efektiv,
- Vendosja e standarteve dhe vlerave të njësisë,
- Shqyrtimi i raporteve të auditimit,
- Shqyrtimi i përmirësimeve të sugjeruara.
- Krijimi i kushteve për komunikim efektiv në lidhje me risqet në mjedis të gjithë palëve të interesuara,
- Ndjekja e zbatimit të planit të veprimit dhe planit të kontrollit,
- Monitorimi i fondeve buxhetore mbi përdorimin e tyre me efikasitet dhe efikasitet si dhe raportimin mbi mbarëvajtjen e tyre.

GMS duhet të mbledhet të paktën 4-herë në vit. Vendimmarrjet duhet të jenë objektive dhe të merren si grup.

2.2 Grupet e Punës të ngritura për sistemet informatike (e-tax dhe fiskalizim) do të mundësojnë dhe sigurojnë si më poshtë:

- Mbështetjen e nevojshme për pikat e vetme të kontaktit për to.
- Menaxhimin e punës, jo vetëm për garantimin e kryerjes së detyrave të duhura, në afatet e përcaktuara nga ofruesi, por edhe të sigurojë informacionin e duhur për përmbushjen e tyre.
- Garantimin e implementimit të plotë të sistemeve.
- Koordinimin, zhvillimin e takimeve që do të kryhen, në zbatim të kontratatave midis ofruesit/eve dhe grupeve të punës, si dhe koordinimin me institucione të tjera.
- Menaxhimin dhe monitorimin e ndryshimeve të nevojshme, mbi komponentët dhe proceset e sistemit.
- Shqyrtimin dhe zgjidhjen e problematikave teknike, të cilat do të lindin nga përdorimi i sistemeve.
- Kryerjen e funksioneve dhe detyrave të Help Desk për to.

2.3 **Komisioni i Disiplinës** i ngritur me Urdhër nr. 21, datë 10.04.2017, "Për ngritjen e Komitetit Disiplinor", është ngritur në mbështetje të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimtarjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014 "Për elementet kryesore proceduriale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore" të Departamentit të Administratës Publike, pranë DPT.

Ky Komision funksionon dhe ushtron detyrat në respektim të parashikimeve të legjislacionit për shërbimin civil dhe është përgjegjës për trajtimin korrekt, brenda afateve ligjore dhe me objektivizëm të shkeljeve disiplinore të konsumuara.

Anëtarët e grupit, detyrat si dhe modalitetet e tjera përcaktohen në Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.

2.4 **Komisioni i Posaçëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga administrata tatimore** i ngritur me Urdhër nr. 25, datë 24.04.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve është ngritur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe bazuar në Urdhër të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 5151, datë 28.10.2015 "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil". Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij komisioni janë ato të përcaktuara në Urdhër mbi bazën e së cilit ky komision është krijuar.

Çdo muaj, Komisioni raporton pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve lidhur me rastet e trajtuara dhe problematikat e hasura në praktikë.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij Urdhëri, Urdhëri nr. 16 datë 02.03.2018 "Për ngritjen e komiteteve të menaxhimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si dhe përcaktimi i rregullave të funksionimit për grupet e përhershme të punës", i ndryshuar, shfuqizohet.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Komitetet, Sekretariatet dhe Grupet e Punës si më sipër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Delina Ibrahimaj